



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 49 Akti

Nr. 51 Vendimi

Tiranë më, 25.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland	ILIA	Kryesues
Etleda	ÇIFTJA	Anëtare
Firdes	SHULI	Relatore

me sekretare gjyqësore, znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 23.07.2018, ora 11:00 dhe më datë 25.07.2018, ora 10:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ardian Dvorani**, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet e provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Ardian Dvorani, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Ardian Dvorani është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë Tiranë që nga viti 2005. Duke qenë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar në shortin e datës 30.11.2017.

3. Me shkresën nr. 624/31, datë 17.11.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 518 prot., datë 22.11.2017, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ardian Dvorani (32 fletë), si dhe 2 dosje me nr. IND 398 V.

4. Me shkresën nr. 11421 prot., datë 26.10.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. 21 prot., datë 15.11.2017, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani (12 fletë).

5. Me shkresën nr. 2911/2 prot., datë 10.11.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, nr. 844 prot., datë 07.12.2017, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani (22 fletë).

6. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (me poshtë referuar si “Komisioni”), ka zhvilluar shortin në datën 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga

komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, Komisioni ka vendosur që komisionerja Alma Faskaj, për arsye objektive, të zëvendësohet nga komisionerja Etleda Çiftja.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues administroi:

7.1 Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë referuar si “ILDKPKI”);

7.2 Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar si “DSIK”),

7.3 Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë referuar si “KLD”).

8. Me vendimin nr. 1, datë 06.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Ardian Dvorani, duke përfshirë të tre kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin z. Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit. Komisionere Etleda Çiftja, e cila ka zëvendësuar komisioneren Alma Faskaj, ka deklaruar mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit, ditën e zëvendësimit të saj, në datën 23.05.2018.

9. Me vendimin nr. 2, datë 05.07.2018, trupi gjykues vendosi:

9.1 Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me verifikimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani.

9.2 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

9.3 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9.4 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

10. Në datën 16.07.2018, subjekti i rivlerësimit njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit parashtresë me pretendimet e tij dhe dokumente shkresore bashkëngjitur.

11. Me vendimin nr. 3, datë 18.07.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 23.07.2018, ora 11:00 paradite, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i 2-të, Tiranë.

12. Më datë 23.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, bazuar në të tre komponentët: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURISË

II.1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2004 deri në vitin 2016. Në datën 31.01.2017, sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar *“Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”* pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me aktin nr. 624/31 prot., datë 17.11.2017, ka konkluduar se:

- Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- Ka kryer fshehje të pasurisë;
- Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, ky institucion nuk është shprehur nëse subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nëse subjekti ka kryer deklaram të rremë, sipas germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të këtij ligji.

II.2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

- a) Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- b) Verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c) Evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- ç) Evidentimin e deklaratimeve të rreme;
- d) Nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit.

me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ është kryer për pasuritë si vijojnë:

- 1. Apartament banimi**, në qytetin e Tiranës, me sip. 104.3 m², i blerë nëpërmjet privatizimit me kontratë noteriale datë 16.06.1993, e regjistruar në hipotekë me nr. *******, datë 22.06.1993, në emër të subjektit, z. Ardian Dvorani (1/5), dhe katër familjareve të tij, me vlerë blerje 21,595.00 lekësh, me burimi krijimi të ardhura nga puna. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe babai i subjektit¹.

Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

1.1 ZVRPP Tiranë² ka konfirmuar bashkëpronësinë e subjektit në 1/6-tën pjesë mbi pasurinë me numër pasurie *******, si dhe ka vënë në dispozicion të gjithë praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie. Për këtë pasuri, rezultojnë 6 bashkëpronarë dhe jo 5, siç ka deklaruar subjekti.

1.2 Kjo pasuri është deklaruar:

- Në deklaratën e vitit 2003 si shtëpi banimi e blerë në vitin 1993 nga NKB, me shumën 21.595 lekë, me burim krijimi nga të ardhura të përbashkëta të punës, pjesa takuese e subjektit është 1/5.
- Në Deklaratën - Vetting rezulton me po të njëjtat deklaratime.

¹ Shih Deklaratën – Vetting, nr. 1, të “Përshkrimi i pasurive”, deklarimi i subjektit dhe babait të tij, në dosjen e ILDKPKI-së.

² Shih shkresën nr. 45832/1, datë 12.01.2018, në dosjen e Komisionit.

Në përfundim rezultoi se, për këtë pasuri ka një lapsus në deklaratimet e subjektit, pasi ai është bashkëpronar mbi 1/6-tën pjesë dhe jo 1/5-tën pjesë, siç ka deklaruar, gjë të cilën ai e ka pranuar në deklaratimet e tij gjatë komunikimit me Komisionin. Nuk kanë rezultuar pasaktësi të tjera dhe dyshime për këtë pasuri.

- 2. Apartament banimi**, Tiranë, me sip. 76.8 m², i blerë me kontratë privatizimi, datë 29.06.1995, në bashkëpronësinë e bashkëshortes së subjektit (1/5) dhe katër bashkëpronarëve të tjerë, anëtarë të familjes, me sip. 76.8 m², me burim krijimi të ardhura nga puna dhe pensionet. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij³.

Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

2.1 ZVRPP-ja konfirmon⁴ se pasuria me nr. *******, apartament banimi, me sipërfaqe 76.8 m², figuron në emër të pesë bashkëpronarëve, ku bashkëshortja e subjektit, znj. E. D., (Dvorani), ka 1/5-tën pjesë të pandarë, si dhe është vënë në dispozicion e gjithë praktika e regjistrimit të kësaj pasurie.

2.2 Kjo pasuri është deklaruar:

- Në deklaratën e vitit 2012 nga bashkëshortja e subjekti (pasi znj. E. D., ka fituar statusin e bashkëpronares ligjore në vitin 2011, sipas vërtetimit të ZVRPP-së),
- Në Deklaratën - Vetting me po të njëjtat deklarime.

Në përfundim, për këtë pasuri nuk kanë rezultuar pasaktësi dhe dyshime.

- 3. Apartament banimi**, me sip. 120 m², Tiranë, bashkëpronësi e subjektit me bashkëshorten, e përfituar nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes, nr. ******* rep., nr. ******* kol., datë 25.07.2001, midis ******* sh.a., dhe shoqërisë ******* sh.p.k., lidhur në vitin 2001, me vlerë 34.410 USD, krijuar me kontribut financiar të ******* sh.a.⁵

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se:

3.1 ZVRPP Tiranë⁶ nuk e ka konfirmuar këtë pasuri. Subjekti ka deklaruar (në deklaratat e pasurisë) dhe konfirmuar (gjatë procesit të rivlerësimit), se nuk i ka kaluar pronësia në rrugë ligjore, për shkak se nuk është lidhur kontrata e shitjes me akt noterial.

3.2 Kjo pasuri është deklaruar:

- Në deklaratën e pasurisë për vitin 2004, si apartament banimi 118 m², me vlerë 34,410 USD, vit në të cilin ka filluar të kryejë shlyerjen e detyrimeve ndaj ******* sh. a.
- Në Deklaratën - Vetting, si apartament banimi, me vlerë 34,410 USD, shlyerja e detyrimit për të cilin ka filluar që në vitin 2004 dhe ka përfunduar në mars 2013. Burimi i krijimit: me kontribut financiar nga ******* sh.a., ku subjekti ka qenë zëvendëskryetar i Këshillit Mbikëqyrës. Përputhen deklaratimet.

³ Shih Deklaratën - Vetting, nr. 1 të "Përshkrimi i pasurive", deklarimi i subjektit dhe bashkëshortes së tij, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Shih shkresën nr. 45832/1, datë 12.01.2018, në dosjen e Komisionit.

⁵ Shih Deklaratën - Vetting, nr. 2, të kolona "Përshkrimi i pasurive", në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶ Shih shkresën nr. 45832/1, datë 12.01.2018, në dosjen e Komisionit.

3.3 Edhe pse kjo pasuri rezulton të jetë krijuar jashtë periudhës së rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një procedurë të thellë hetimi administrativ, për shkak të disa paqartësive në lidhje me fitimin e pronësisë, sipërfaqen e apartamentit, çmimin e blerjes dhe mënyrën e likuidimit të tij.

3.4 Pas kërkimit të bërë pranë “***” sh.a., ky institucion⁷ ka vënë në dispozicion informacion të hollësishëm për këtë pasuri, nga ku rezulton se:

3.4.a Në vitin 2000, ky institucion ka vendosur të pajisë me banesë disa nga punonjësit, ndër të cilët dhe subjektin e rivlerësimit⁸.

3.4.b Në vendimin e “***” sh.a., nr. ***, datë 02.02.2000, është përcaktuar se kontributi maksimal i këtij institucioni për sipërfaqen 93 m², do të jetë deri në vlerën 34,410 USD.

3.4.c Me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2001, shoqëria “***” sh.a., ka porositur te shoqëria sipërmarrëse “***” sh.p.k., një apartament banimi me sipërfaqe 120 m² për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, me çmim shitjeje 34,410 USD. (Në paragrafin 2.4 të kësaj kontrate shkruhet *apartamenti destinohet për z. A. Dvorani, të drejtat dhe detyrimet e të cilit do të përcaktohen në kontratë të veçantë*).

3.4.d Me propozim të “***” sh.a., është vendosur t’i ofrohet blerësit, z. Dvorani, ulje e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes, me kusht që pagimi të bëhet në mënyrë të menjëhershme, brenda datës 31.03.2013⁹.

3.5 Nga informacioni i mësipërm, kanë rezultuar paqartësi lidhur me sa vijojnë :

3.5.a. Nuk ka një kontratë të veçantë midis subjektit dhe “***” sh.a., ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

3.5.b. Ndërkohë që kontributi maksimal i “***” sh.a., për sipërfaqen 93 m², ishte përcaktuar deri në vlerën 34,410 USD, kontrata e sipërmarrjes ka për objekt apartament banimi prej 120 m², në vlerën prej 34,410 USD. Pra, subjekti ka paguar po të njëjtën vlerë për një sipërfaqe më të madhe (120 m²).

3.5.c. Blerësit i është ofruar ulje e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes, me kusht që pagimi të bëhet në mënyrë të menjëhershme, brenda datës 31.03.2013.

3.6 Lidhur me këto paqartësi, është pyetur “***” sh.a.¹⁰ dhe subjekti i rivlerësimit¹¹, deklaratimet e të cilëve përputhen me njëri-tjetrin. Nga këto deklaratime rezultoi e vërtetuar se:

⁷ Shih shkresën nr.9333/4, datë 23.02.2018, shkresën nr. 9333/1, datë 28.12.2017, pranë Komisionit

⁸ Shih shkresën nr. 6355, të “***” sh. a., dhe listën bashkangjitur, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shih shkresën nr. 615 prot., datë 26.02.2013, në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Shih, përgjigjen e “***”, me shkresën nr. 9333/4, datë 23.02.2018, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shih, përgjigjen e subjektit, datë 09.02.2018, në dosjen e Komisionit.

3.6.a. Në asnjë rast tjetër nuk është lidhur një kontratë specifike midis “***” sh.a., me subjektin e rivlerësimit, dhe as me punonjës të tjerë përfitues nga skema e lehtësive financiare për strehim.

3.6.b. Lidhur me mospërputhjen e vendimit të “***” sh. a., nr. ***, datë 02.02.2000, me kontratën e sipërmarrjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2001, për sa i përket sipërfaqes së apartamentit, nga hetimi administrativ rezultoi se ka qenë vullneti i “***” sh.a. për të porositur një apartament banimi me sipërfaqe më të madhe (120 m²) nga ajo e planifikuar (93 m²) pranë shoqërisë ndërtimore “***” sh.p.k., e cila nga ana e vet ia ka ofruar këtë mundësi subjektit nëpërmjet kontratës me “***” sh.a., duke nënshkruar këtë kontratë për apartament banimi, me sipërfaqe 120 m², destinuar për z. Ardian Dvorani.

3.6.c. Nuk rezultoi që subjekti të këtë bërë ndonjë kërkesë apo deklaratë lidhur me sipërfaqen e banimit, madje nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje apo kontratë me “***” sh.a., apo dhe me firmën ndërtuese. Kjo kontratë është lidhur midis “***” sh.a. dhe shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k.

3.6.d. Lidhur me uljen e pjesës së mbetur të çmimit të shitjes në shumën prej 1.761.722 lekësh, nga hetimi administrativ rezultoi se kjo zbritje është bërë nga “***” sh.a., në bazë të një politike të brendshme të shoqërisë, të analizuar nga drejtoria ekonomike e institucionit, duke u bërë një ofertë për të gjithë punonjësit që kishin marrë kredi për apartamente, të cilët kishin paguar rregullisht këstet, duke përfshirë dhe subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani.

Në përfundim të hetimit administrativ për apartamentin me sipërfaqe prej 120 m², rezultoi se:

Kjo pasuri është përfituar nga subjekti (jashtë periudhës së rivlerësimit, gjatë kohës që ai ka qenë, zëvendëskryetar i Këshillit Mbikëqyrës të “***” sh.a., në vitin 2001) me vullnetin e lirë dhe në përputhje të plotë me procedurat ligjore të miratuara dhe të zbatuara nga “***” sh.a., institucioni që ka kontribuar financiarisht për blerjen e saj. Nuk vërtetohet që subjekti të këtë kryer veprime në kundërshtim me ligjin dhe me qëllime përfitimi. Gjithashtu, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pagimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie.

- 4. Pasuri e luajtshme- autoveturë**, tip “Skoda Octavia Ambition”, prodhim i vitit 2016, me targë ***, përfituar me qira financiare me të drejtë blerjeje, në çmimin prej 19,500.00 eurosh. Parapaguar 3,900.00 euro, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.07.2016, të lidhur me “Credins Bank”, në korrik 2016.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se:

Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor¹² nuk e konfirmon këtë automjet (pasi nuk është bërë likuidimi i total i çmimit të shitjes dhe regjistrimi në këtë institucion). Gjithashtu, nuk figuron i regjistruar, asnjë mjet tjetër në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

¹² Shih shkresën nr. 23887/1, datë 28.12.2017, në dosjen e Komisionit.

Për këtë pasuri nuk kanë rezultuar dyshime. Pas analizës financiare, të kryer gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar shumën e parapaguar prej 3,900 eurosh.

5. Likuiditetet e padeklaruara: ILDKPKI¹³, gjatë procesit të vlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk kanë deklaruar në Deklaratën - Vetting likuiditetet në të gjitha llogaritë bankare në shumën prej 9,975,000 lekësh, dhe e ka konsideruar këtë si deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin. Ndërkohë, likuiditetet e padeklaruara i ka konsideruar si fshehje pasurie.

Gjatë hetimit administrativ, pas informacionit të marrë nga bankat e çdo niveli, ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk kanë deklaruar në Deklaratën - Vetting likuiditetet e përmbledhura në tabelën më poshtë:

Banka	Nr. llogarie	Monedha	Vlera	Nr. shkresës/data
Tirana Bank				
E. D.	***	Lekë	670,018	Shkresë, nr. 301 prot., datë 05.01.2018
E. D.	***	Lekë	3,500,000	Shkresë, nr. 301 prot., datë 05.01.2018
E. D.	***	Lekë	300,000	Shkresë, nr. 301 prot., datë 05.01.2018
Intesa Sanpaolo Bank				
Ardian Dvorani	***	Lekë	401,025	Shkresë, nr. 17/64068/1, datë 29.12.2017
Credins Bank				
DVORANI ARDIAN	***	Lekë	349,666	Shkresë nr. 9060/1, datë 02.03.2018
DVORANI ARDIAN	***	Lekë	-100	Shkresë nr. 9060/1, datë 02.03.2018
DVORANI ARDIAN	***	Euro	4	Shkresë nr. 9060/1, datë 02.03.2018
DVORANI ARDIAN	***	USD	5,153	Shkresë nr. 9060/1, datë 02.03.2018
D. E.	***	Lekë	169	Shkresë nr. 9060/1, datë 02.03.2018
D. E.	***	Lekë	2,000,000	Shkresë nr. 9060/1, datë 02.03.2018
TOTAL EKVIVALENT NË LEKË			7,882,353	

Intesa Sanpaolo Bank	Nr. llogarie	Monedha	Vlera	Nr. shkresës/data
M. & K. D.	***	Lekë	2,000,000	Shkresë nr. 17/64068/1., datë 29.12.2017
M. & K. D.	***	Lekë	98,637	
TOTAL NË LEKË			2,098,637	

Nga sa më sipër, rezulton se totali i gjithë likuiditeteve të padeklaruara në Deklaratën - Vetting është 9,980,990 lekë. (7,882,353 lekë likuiditete të subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe 2,098,637 lekë likuiditete të prindërve të tij).

¹³ Shih raportin e ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

II.3 ANALIZË FINANCIARE

Analiza financiare¹⁴ është bërë mbi bazën e përlllogaritjes së të ardhurave, shpenzimeve, vlerave të pasurive të paluajtshme dhe pasurive të luajtshme, duke përfshirë dhe likuiditetet e padeklaruar, për subjektin dhe personat e lidhur me të, me qëllim evidentimin e vlerave të pajustificuara me burime të ligjshme. Konkretisht:

1. Nga analiza financiare për subjektin, bashkëshorten dhe djalin e tyre, e cila është bazuar në deklaratat periodike dhe në Deklaratën -Vetting, si dhe dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

Kjo analizë, pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

VITET	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
TE ARDHURAT	1,843,363	2,342,200	2,162,154	2,555,074	2,682,557	3,080,076	3,022,227	3,091,221	3,082,806	5,233,501	5,492,901	5,850,267	5,763,155	7,622,608
PASURI NETO	392,593	1,531,186	-873,960	-48,149	-298,988	460,831	425,345	346,681	-690,815	1,576,664	2,527,813	940,968	1,576,113	2,265,334
SHPENZIME	512,143	750,832	2,612,795	1,155,487	1,283,776	1,376,063	1,840,804	1,145,284	2,100,407	2,223,868	2,523,039	1,435,832	1,137,956	2,816,666
PASURI NETO+ SHPENZIME	904,736	2,282,018	1,738,835	1,107,338	984,788	1,836,894	2,266,149	1,491,964	1,409,592	3,800,532	5,050,853	2,376,801	2,714,069	5,082,000
TE ARDHURA -PASURI NETO-SHPENZIME	938,627	60,182	423,319	1,447,736	1,697,769	1,243,182	756,078	1,599,257	1,673,214	1,432,968	442,048	3,473,466	3,049,086	2,540,607

2. Nga analiza financiare për prindërit e subjektit (të cilët figurojnë të jenë në të njëjtin trung familjar me subjektin e rivlerësimit sipas certifikatës familjare -me datë lëshimi 27.01.2017), e cila është bazuar në Deklaratën - Vetting, si dhe dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni, rezultoi se ata kanë burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

Kjo analizë, pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Analiza financiare për prindërit e subjektit		Shuma në lekë
TË ARDHURA		ALL 12,268,321
	Të ardhura nga pensionet për nënën K. D.	ALL 3,971,246
	Të ardhura nga dëmshpërblimi sipas ekzekutimit të vendimit nr. 9618, datë 25.11.2011	ALL 2,716,983
	Të ardhura nga pensionet për babain M. D.	ALL 2,863,109
	Të ardhura nga dëmshpërblimi sipas ekzekutimit të vendimit nr. 9618, datë 25.11.2011	ALL 2,716,983
SHPENZIME		ALL 4,450,000
	Shpenzime jetese sipas standardit të ILDKPKI-së	ALL 4,450,000
Diferenca e mundshme për kursim		ALL 7,818,321

Metodologjia e përdorur për analizën financiare

Analiza financiare është bazuar në:

¹⁴ Shih, analizën financiare në dosjen e Komisionit.

1. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Procredit Bank”¹⁵, “Raiffeisen Bank”¹⁶, “Tirana Bank”¹⁷, “Intesa Sanpaolo Bank”¹⁸, “Credins Bank”¹⁹.

2. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen: (i) Të ardhurat nga pagat në Ministrinë e Drejtësisë²⁰, të ardhurat nga INSIG²¹, të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë²², të ardhurat nga paga në Shkollën e Lartë Jopublike “Qirjazi”²³, të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës²⁴, të ardhurat nga mësimdhënia në shkollën “Luarasi”²⁵, të ardhurat nga OSBE-ja²⁶, të ardhura nga Dhoma e Avokatisë²⁷, të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit nr. 00-2012-2575, datë 12.12.2012, të Gjykatës së Lartë²⁸; (ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë INSIG²⁹, të ardhurat nga pagat e bashkëshortes pranë shoqërisë “***”³⁰, të ardhurat nga pagat e bashkëshortes pranë INSIG³¹, të ardhura nga pagat e bashkëshortes pranë shoqërisë “***”³², të ardhura nga pagat e bashkëshortes pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit³³, të ardhura nga puna në INSIG³⁴, të ardhura të bashkëshortes nga ekzekutimi i vendimit nr. 00-2014-216, datë 13.02.2014, Gjykata e Lartë³⁵; (iii) Të ardhura nga pensionet e prindërve të subjektit³⁶

3. Shpenzimet, ku përfshihen : (i) Shpenzimet e jetesës bazuar në anketimet e INSTAT-it; (ii) Shpenzime udhëtimi, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit në rastet kur nuk kemi të dhëna nga subjekti, janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat lowcost deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi; (iii) Shpenzime të shkollimit të djalit pranë shkollës “***”; (iv) Shpenzime kurimi sipas deklaramentit të subjektit; (v) Shpenzime arredimi, sipas deklaramentit të subjektit.

4. Në vlerat e pasurisë së paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 120 m² ³⁷.

¹⁵ Shkresa nr. 56549/1 prot., datë 06.01.2018.

¹⁶ Shkresa, nr. 46450/1 prot., datë 26.12.2017.

¹⁷ Shkresa, nr. 301 prot., datë 05.01.2018.

¹⁸ Shkresa, nr. 17/64068/1 prot., datë 29.12.2017.

¹⁹ Shkresa, nr. 9060/1 prot., datë 02.03.2018.

²⁰ Shkresa, nr. A19 prot., datë 17.01.2017, Ministria e Drejtësisë.

²¹ Shkresë, Departamenti i Thesarit, datë 25.03.2005.

²² Shkresa nr. 12/19, datë 19.01.2017, nga Gjykata e Lartë.

²³ Dokument bankar nga “Credins Bank”. Vërtetim nga shkolla “Qirjazi”.

²⁴ Shkresa, nr. 846/1 prot., datë 25.10.2016., nga Shkolla e Magjistraturës.

²⁵ Vërtetim nga shkolla “Luarasi”, datë 20.12.2016.

²⁶ Vërtetim nga OSBE, datë 27.10.2016.

²⁷ Shkresa, nr. 301 prot., datë 20.12.16, nga Dhoma e Avokatisë.

²⁸ Vërtetim nga Intesa Sanpaolo për kalimin e shumës.

²⁹ Shkresa, nr. 179 prot datë 24.01.2017 nga INSIG.

³⁰ Shkresë, extra prot., datë 20.01.2017., nga ***.

³¹ Shkresë, nr 179 prot., datë 24.01.2017., nga INSIG.

³² Shkresa, nr 8600/1, datë 09.08.17., nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

³³ Shkresa, nr 413 prot, datë 20.01.2017, nr. 1379 prot., datë 19.02.2016, nr. 1284 prot., datë 12.02.2015, nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

³⁴ Vërtetime në muajt mars të çdo viti pasardhës nga INSIG.

³⁵ Dokument bankar “Procredit Bank”.

³⁶ Shkresa nr. 183 prot., datë 20.01.2017, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

³⁷ Shih, kontratën e sipërmarjes nr.5640 rep., nr.847 kol, datë 25.07.2001, në dosjen e Komisionit.

5. Për llogaritjen e vlerave të detyrimeve ndaj të tretëve për blerjet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, kjo analizë është bazuar në: kontratën me “***” për blerjen e apartamentit³⁸; kontratën me “Credins Bank” për kredinë për makinën e blerë në vitin 2004³⁹; kontratën me “Credins Bank” për makinën e blerë në vitin 2016⁴⁰; në huan e marrë nga prindërit për shlyerjen e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit⁴¹.

II.4 NË LIDHJE ME MOSDEKLARIMIN E LIKUIDITETEVE

Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se:

1. Në deklaratat periodike janë deklaruar rregullisht, në mënyrë të detajuar dhe të dokumentuar, të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes, pasuritë, burimi i krijimit, si dhe të gjitha likuiditetet në llogaritë bankare të tyre, detyrim sipas nenit 7, pika 5, dhe nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, të ndryshuar.
2. Deklarimi i fundit para Deklaratës - Vetting (datë 31.01.2017), është ai i bërë në datën 30.03.2016, nga ku rezulton të jenë deklaruar në mënyrë të detajuar dhe të dokumentuar të gjitha ndryshimet në likuiditetet e subjektit dhe bashkëshortes, sipas ligjit të sipërpërmendur.
3. Në Deklaratën - Vetting, datë 31.01.2017, rezulton që subjekti dhe personat e lidhur me të (që janë bashkëshortja, djali dhe prindërit, sipas nenit 3, pika 13, dhe formularit shtojca 2 të deklaratës së pasurisë të ligjit nr. 84/2016), kanë deklaruar saktësisht dhe në mënyrë të detajuar dhe të dokumentuar, të ardhurat nga pagat, pensionet dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme. Por nuk kanë deklaruar llogaritë bankare (llogari rrjedhëse dhe depozita kursimesh), me likuiditetet përkatëse të krijuara nga të ardhurat e mësipërme, në total në shumën 9.980. 990 lekë.
4. Gjatë procesit të vlerësimit të pasurive nga ILDKPKI, ky institucion ka administruar deklarinimet periodike të subjektit ndër vite dhe Deklaratën - Vetting, si dhe çdo dokumentacion justifikues të pasurive dhe të ardhurave të ligjshme për subjektin dhe personat e lidhur, si dhe ka verifikuar në rrugë institucionale nëpërmjet organeve kompetente dhe bankave të çdo niveli, çdo pasuri, çdo të ardhur dhe gjendjet e likuiditeteve të subjektit ndër vite. Nga verifikimet, ka rezultuar se të dhënat e deklaruara në deklaratat periodike dhe në Deklaratën-Vetting nga subjekti dhe personat e lidhur, përputhen me të dhënat e siguruara zyrtarisht nga ILDKPKI. Por, ndërkohë, pasi është konstatuar se në Deklaratën - Vetting nuk janë deklaruar të gjitha llogaritë bankare me likuiditetet përkatëse, në emër të subjektit dhe personave të lidhur, ky institucion e ka konsideruar këtë si fshehje pasurie.
5. Gjatë procesit të rivlerësimit është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka reaguar që në momentin që ka marrë dijeni se për të ka filluar procesi i rivlerësimit⁴², dhe ka dhënë sqarime të hollësishme rreth këtij fakti. Po kështu, ai ka dhënë sqarime të detajuara shoqëruar me

³⁸ Shih Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 27.07.2001, në dosjen e Komisionit.

³⁹ Shih Shkresë nr 63642/1 prot., datë 11.01.2018, nga “Credins Bank” në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Shih Kontratë qiraje financiare (leasing) me nr.1687 rep., nr.709 kol., datë 06.07.2016, me “Credins Bank”.

⁴¹ Shih Shkresë nr. 17/64065/1, datë 29.12.2017, nga” Intesa Sanpaolo Bank” në dosjen e Komisionit

⁴² Shih përgjigjet e subjektit të datës 28.12.2017, në dosjen e Komisionit në dosjen e Komisionit.

dokumente bankare, pasi është njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit⁴³, si dhe gjatë seancës dëgjimore⁴⁴.

6. Në parashtrimet e tij, subjekti pranon një pasaktësi të dukshme në formularin e deklarimit të pasurisë për Vetting, për shkak së nuk gjenden fizikisht katër faqe me deklarimin e likuiditeteve, dhe e shpjegon mungesën e deklarimit të të gjitha likuiditeteve të tij dhe personave të lidhur me të, për shkak të pakujdesisë dhe ngarkesës në momentin e mbledhjes së të dhënave për plotësimin e Deklaratës - Vetting, pa asnjë lloj motivi dhe qëllimi për fshehje pasurie, duke reflektuar një qëndrim kritik ndaj vetes për këtë pakujdesi, si dhe duke argumentuar ndërkohë mungesën totale të fshehjes së pasurisë (likuiditetet e padeklaruara).

7. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi deklaratat periodike të subjektit në vite për periudhën 2003 - 2016, si dhe deklaratën për vetting, konstatoi se:

7.1 Në Deklaratën - Vetting, të datës 31.01.2017, nuk janë deklaruar likuiditetet në të gjitha llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur (ndërkohë që janë deklaruar saktësisht të ardhurat nga pagat, pensionet dhe çdo e ardhur tjetër, që përbëjnë burimin e krijimit të tyre). Në këtë mënyrë, subjekti nuk ka përmbushur një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 3 pika 11 dhe shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, fakt që e bën deklarimin të pasaktë.

7.2 Për të arritur në një konkluzion nëse subjekti ka kryer fshehje pasurie, ky trup gjykues çmoi se duhet marrë në konsideratë: lidhja shkakësore midis mosdeklarimit të likuiditeteve dhe pasojës që ka ardhur nga ky mosdeklarim, qëllimi/dashja në mosveprimin e subjektit, si dhe verifikoi nëse këto likuiditete të padeklaruara ishin nga burime të ligjshme apo jo.

Arsyetim ligjor lidhur me faktin nëse është kryer fshehje pasurie nga ana e subjektit, në kuptim të nenit 33, pika c, të ligjit nr. 84/2016:

Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditetet në shumën 9,980,990 (nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë në Deklaratën - Vetting 2017, nuk përbën fshehje të këtyre likuiditeteve, bazuar kjo në ligj dhe në prova, për arsyet si vijojnë:

1. Neni 33, pika 5, germa “c”, i ligjit nr. 84/2016, parashikon fshehjen e pasurisë, si një nga konstatimet gjatë procedurave të vlerësimit të pasurisë, sipas kësaj dispozite ligjore. Neni 3 i këtij ligji, i cili parashikon përkufizime për disa terma, nuk ka dhënë një përkufizim të termit “fshehje pasurie”. Gjithashtu, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” etj., dispozita ligjore, të cilave Komisioni u referohet gjatë procedurave të vlerësimit të pasurisë, nuk ka një përkufizim të termit “fshehje” apo “fshehje pasurie”, për përdorimin e tij në vendimmarrjen gjatë një procesi administrativ.

⁴³ Shih parashtrësën e datës 16.07.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ Shih përmbledhjen e parashtrimeve në seancë dëgjimore, në dosjen e Komisionit.

2. Nisur nga koncepti i fjalës “fshehje”⁴⁵ (*E vë dikë a diçka në një vend që të mos e shohin a të mos e gjejnë të tjerët, ... I/E fshehtë, konsiderohet diçka që nuk është zbuluar a nuk është njohur ende*), kuptohet që subjekti nuk i ka fshehur likuiditetet në llogaritë bankare të tij dhe personave të lidhur, përderisa këto likuiditete dhe burimet e krijimit të tyre janë bërë të ditura prej tij në deklaratimet periodike. Ndërkohë, në Deklaratën - Vetting janë deklaruar saktësisht të ardhurat nga pagat, pensionet e prindërve dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, që përbëjnë burimin e likuiditeteve të padeklaruar në emër të tyre.

3. Në dispozita të tjera ligjore që përfshijnë konceptin e fshehjes, ky term i referohet një veprimi me sjellje aktive (duke fshehur, maskuar, mbuluar pasurinë, të ardhurat, etj.), ose një mosveprimi me sjellje pasive (në rastin kur subjekti ka një detyrim ligjor për të vepruar). Në të dyja rastet, qëllimi është i njëjtë: për të fshehur pasurinë, për të mbuluar apo për të maskuar burimin e krijimit, vendndodhjen, disponimin ose lëvizjen e vlerave monetare e materiale, etj.

4. Fakti që subjekti dhe bashkëshortja e tij, znj. E. D., në deklaratat periodike kanë deklaruar rregullisht likuiditetet, burimet e krijimit dhe ndryshimet e tyre ndër vite deri në vitin 2016, (detyrim sipas nenit 7 pika 5 dhe nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar), tregon se mosdeklarimi i likuiditeteve në shumën prej 7,882,353 lekë në Deklaratën – Vetting (2017), nuk është bërë me qëllim fshehje, dhe as për t’iu shmangur një detyrimi ligjor, të cilin subjekti e ka përmbushur rregullisht ndër vite, por është thjesht një harresë nga ana e tij.

5. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për likuiditetet në emër të prindërve, të cilat nuk janë deklaruar në Deklaratën – Vetting. (Ndërkohë nuk ka qenë detyrim ligjor për ata deklarimi periodik.) Konstatohet se në këtë deklaratë janë deklaruar dhe dokumentuar të ardhurat e tyre nga pensionet dhe burime të tjera të ligjshme (sipas nenit 3, pika 13, dhe formularit shtojca 2 e deklaratës së pasurisë të ligjit nr. 84/2016), por nuk janë deklaruar llogaritë bankare me likuiditetet përkatëse, burim për krijimin e të cilave kanë shërbyer këto të ardhura. Mosdeklarimi i likuiditeteve në shumën 2,098,637 lekë, edhe në këtë rast nuk rezulton të jetë bërë me qëllim fshehjen e tyre, por është gjithashtu pakujdesi në plotësimin e Deklaratës-Vetting, në të cilën, siç ka rezultuar, mungojnë tërësisht likuiditetet e subjektit dhe personave të lidhur me të.

6. Sipas nenit 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i cili parashikon se “kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaratimet nuk janë të sakta dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, inspektorati thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse”. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, ILDKPKI-ja mund të thërriste subjektin për sqarime të hollësishme dhe argumentet përkatëse lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve. Në dosjen e ILDKPKI-së, nuk ka një dokument që të vërtetojë këtë. Gjithashtu, në raportin për vlerësimin e pasurisë nuk është përmendur fakti se subjektit i janë kërkuar sqarime (detyrim ligjor sipas dispozitës së sipërpërmendur), përpara se të arrihej në konkluzionin se ai ka konsumuar fshehje pasurie.

⁴⁵ Sipas fjalorit të gjuhës shqipe.

7. Gjatë analizës financiare për likuiditetet e padeklaruara⁴⁶, pasi janë verifikuar të gjitha të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur me të, mbështetur në deklaratat periodike dhe informacionin bankar të marrë në rrugë ligjore, është konstatuar se:

7.1. Subjekti dhe personat e lidhur kanë deklaruar rregullisht në vite likuiditetet dhe burimin e krijimit të tyre që nga momenti i krijimit, deri në deklarinimin për vitin 2016.

7.2 Llogaritë bankare të padeklaruara në Deklaratën - Vetting nga ana e subjektit dhe bashkëshortes (likuiditetet në shumën 7,882,353 lekë) janë po të njëjtat llogari të deklaruara ndër vite dhe në deklaratën periodike për 2016, dhe likuiditetet e këtyre llogarive janë tërësisht të justifikuara me burime të ligjshme të deklaruara nga subjekti, (të ardhurat nga pagat, mësimdhënia).

7.3 Llogaritë bankare të prindërve nuk janë deklaruar në deklaratat periodike, pasi nuk ka qenë detyrim ligjor. Likuiditetet e padeklaruara në llogaritë bankare të prindërve të subjektit në Deklaratën - Vetting, në shumën prej 2,098,637 lekësh, janë tërësisht të justifikuara me burime të ligjshme, të deklaruara dhe të dokumentuara në Deklaratën - Vetting (burime nga pensionet dhe dëmshpërblimi sipas vendimit gjyqësor).

8. Deklaratat periodike ndër vite (në të cilat janë deklaruar rregullisht likuiditetet dhe burimet e krijimit nga subjekti dhe personat e lidhur me të), si dhe ajo për Vetting (ku janë deklaruar saktësisht të ardhurat si burime të ligjshme të krijimit të likuiditeteve të padeklaruara), duhet të merren si provë (parashikuar nga neni 35/2 i ligjit nr. 84/2016) që vërteton se mosdeklarimi i likuiditeteve në Deklaratën - Vetting nuk është bërë me qëllim fshehjen e tyre.

9. Ligji nr. 84/2016, si dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e konsideron procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit si një proces të bazuar jo vetëm në detyrimin formal të subjekteve për të deklaruar me vërtetësi dhe saktësi të dhëna në lidhje me tri kriteret e parashikuara nga ligji, por edhe në qëndrimin që ata mbajnë në raport me gjithë procedurat e rivlerësimit, i cili duhet të reflektojë integritet, si dhe të dëshmojë vërtetësi dhe transparencë në çdo deklarinim, në funksion të forcimit të besimit të publikut te institucionet e sistemit të drejtësisë, qëndrim i cili është konstatuar në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani.

10. Konkretisht, gjatë procesit të rivlerësimit është vërtetuar se:

Ai ka qenë tepër i saktë e i detajuar, në plotësimin deklaratave periodike, Deklaratës -Vetting, dhe deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit, i cili në vetvete është një proces administrativ, gjatë të cilit subjektet e rivlerësimit kanë të drejta të rregulluara nga Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë (nenet 35 - 40 dhe 45 - 47).

Në ushtrim të të drejtave që përcakton neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtën të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes, subjekti ka reaguar që në fillim të procesit të rivlerësimit, duke pranuar pasaktësinë për shkak të mosdeklarimit të likuiditeteve, duke dhënë shpjegime të hollësishme, duke vënë në dispozicion (pa iu kërkuar) dokumentacion të plotë bankar për të

⁴⁶ Shih analizën financiare në dosjen e Komisionit.

gjitha likuiditetet e padeklaruara, si dhe duke dhënë argumentet dhe opinionin e tij cilësisht ligjor, lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve. Bashkëpunimi, gatishmëria maksimale, qëndrimi reflektues ndaj pakujdesisë së treguar, dhe sjelljet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, reflektojnë integritet e vërtetësi, të cilat Komisioni i ka pasur në konsideratë në marrjen e vendimit, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

11. Përfundimisht, bazuar në sa është argumentuar më sipër, si dhe duke mos anashkuar faktin që likuiditet në bankat e çdo niveli (llogari rrjedhëse apo depozita), janë tërësisht dhe lehtësisht të verifikueshme, në çdo kohë dhe nga cilido organ kompetent, Komisioni vlerëson se mungon qëllimi/motivi për fshehje pasurie nga ana e subjektit (dhe e personave të lidhur me të), dhe realisht nuk rezulton që të jetë kryer fshehje pasurie prej tyre.

Si rrjedhim, pasoja e ardhur nga mosdeklarimi i likuiditeteve, nuk duhet të konsiderohet si fshehje pasurie në kuptim të nenit 33 pika 5/c të ligjit nr. 84/2016, por vetëm si një pasaktësi në deklaram.

II.5 REZULTATET PËRFUNDIMTARE NË LIDHJE ME RIVLERËSIMIN E PASURIVE

Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me rivlerësimin e pasurisë, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, ka rezultuar:

- ✓ Deklarim i pasaktë për shkak të mosdeklarimit të likuiditeteve në llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur me të në Deklaratën - Vetting, por, siç u argumentua më lart, pa qëllimin e fshehjes;
- ✓ Ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit, nga 2003 - 2016 (përfshirë këtu dhe likuiditetet e padeklaruara);
- ✓ Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ✓ Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- ✓ Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Bazuar në sa më lart, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, e cila është e justifikuar me burime të ligjshme, bazuar në dokumentacion të plotë ligjor.

III. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të

Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr.11421 prot., datë 26.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, nga verifikimet e kryera nuk rezultoi të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe ka bërë deklarime të sakta dhe me vërtetësi, ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

IV. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Me shkresën e KLD-së, nr. 624/31 prot., datë 17.11.2017, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani.

Sipas pikës 4 të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga ana e relatores është vazhduar me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, parashikuar nga neni 44 i ligjit. Ky rivlerësim është bazuar në:

1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së, bazuar në:

1.1. Formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;

1.2. Pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;

1.3. Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së, mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

Saktësia e formularit të vetëdeklarimit.

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, është nënshkruar në çdo fletë dhe është i rregullt nga pikëpamja formale, me përjashtim të mosplotësimit të rubrikës për *email*-in zyrtar.

Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit:

Subjekti ka deklaruar se nga periudha shkurt 2005 deri më sot ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë.

Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore:

Subjekti ka deklaruar se në 3 vitet e fundit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën e të drejtës administrative, si anëtar dhe Kryesues i Kolegjit, ku i janë caktuar për vitin 2013 - 509 çështje; për vitin 2014 - 383 çështje; për vitin 2015 - 447 çështje dhe për vitin 2016 - 280 çështje. Subjekti ka deklaruar se 3 vitet e fundit ka përfunduar gjithsej si relator 892 çështje gjyqësore. Subjekti ka deklaruar se ka mbartur 1043 çështje, pa specifikuar vitin e referencës për mbartjen.

Trajnimet në 3 vitet e fundit:

Lidhur me trajnimet jashtë Shkollës së Magjistraturës subjekti ka qenë në veprimtari (seminare) të mirëfillta trajnuese, duke paraqitur edhe listën e 9 aktiviteteve, për të drejtën europiane, Gjykatën Europiane, praktikën e GJEDNJ-së, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, për të drejtën administrative dhe unifikimin e praktikave gjyqësore.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor, të cilat janë analizuar nga Inspektorati i Lartë i KLD-së.

Në përfundim, pasi janë marrë në analizë pesë dosjet e përzgjedhura me short dhe tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, janë konstatuar gjetjet si vijojnë:

Për aftësitë profesionale është konstatuar se subjekti ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj, i kushton vëmendje dhe respektimit ose jo të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta. Në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit përdor referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, si dhe është në koherencë të plotë me ndryshimet ligjore, duke evidentuar saktë natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente.

Për arsyetimin ligjor është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor, dhe del në vendime përfundimtare të arsyetuara qartësisht dhe të kuptueshme.

Për aftësitë organizative, pasi është marrë në analizë aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në përbërje të Kolegjit Administrativ si kryesues i tij. Subjekti ka deklaruar së gjatë kësaj periudhe i janë caktuar për gjykim 1619 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar gjithsej 1164 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve është 71.9 %.

Është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në disa raste jashtë afatit ligjor. Në rastin e disponimit mbi konfliktin e kompetencës apo për mospranim rekursi, vendimi i ndërmjetëm është i paarsyetuar, gjë që sipas KLD-së rezulton të jetë është një praktikë e konsoliduar në Gjykatën e Lartë, ashtu sikurse dhe tejkalimet në afatet e gjykimit dhe vonesat në nënshkrimin e vendimeve përfundimtare.

Lidhur me aftësitë për të kryer procedurat gjyqësore dhe administruar dosjet, është konstatuar se subjekti ka aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore si dhe ka aftësi administrative, por nuk janë lënë pa u përmendur disa parregullsi në dokumentimin e procedurave, si mungesa e procesverbaleve të mbajtura në dhomë këshillimi apo relatimeve, për të cilat edhe pse janë detyrime të sekretarisë gjyqësore dhe pavarësisht ngarkesës së lartë në punë, subjekti duhet të ushtronte më shumë kontroll në veprimtarinë e sekretarisë gjyqësore, me qëllim shmangien e tyre.

Në analizë të të dhënave për subjektin të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, nisur nga parregullsitë e konstatuara si më sipër, KLD-ja ka konkluduar se në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së subjektit të rivlerësimit, ka ndikuar ngarkesa e lartë sasiore në punë.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, është konstatuar se subjekti ka treguar etikë dhe integritet në punë, pasi nuk ka të dhëna në lidhje me ndikime apo presione të jashtme të çfarëdo lloji. Gjithashtu është konstatuar se subjekti ka treguar paaftësi në gjykimin e çështjeve, si dhe nuk ka cenuar interesat dhe të drejtat e grupeve në nevojë.

Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional, është konstatuar se subjekti ka aftësi komunikimi me palët dhe aftësi bashkëpunimi me kolegët dhe administratën gjyqësore.

Lidhur me gatishmërinë për t'u angazhuar, subjekti nuk ka pasur detyrimin për t'iu nënshtruar formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Ai ka pasur pjesëmarrje të vazhdueshme si lektor ose ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, shkollës së avokatisë, si dhe në shkolla të larta publike dhe private, OSBE-së, për fushat e së drejtës publike, penale, organizimit gjyqësor, të së drejtës civile materiale dhe procedurale, si dhe në fushën e përgatitjes specifike profesionale dhe etike të gjyqtarëve dhe avokatëve. Subjekti është bashkautor i librit "Vademecum për avokatët", "Këshilla dhe akte për procesin civil", Kreu 7 "Rekursi, ankimi dhe kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë", botuar në vitin 2014 nga OSBE.

2. Vlerësimin e informacionit të marrë në rrugë ligjore, bazuar në:

2.1. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti për efekt të rivlerësimit profesional dhe pesë dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, sipas nenit 43, pika 2, e ligjit, pas analizimit të së cilave nga ana e Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit, rezultuan të njëjtat konstatime si në raportin përfundimtar të KLD-së, nr. 624/31 prot., datë 17.11.2017.

2.2. Tetë denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani⁴⁷.

Nga këto denoncime, katër prej të cilave kanë pasur të bashkëngjitura vendime gjykatash ku subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesëmarrës në gjykime, është konstatuar se mungojnë fakte apo të dhëna për korrupsion të subjektit të rivlerësimit, në rastet që pretendohet.

Lidhur me ankesat për aftësitë profesionale, etikën në punë etj, pasi janë shqyrtuar dokumentat bashkangjitur denoncimeve, gjatë hetimit administrativ nuk kanë rezultuar të dhëna apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, apo cilësi që çenojnë figurën e gjyqtarit.

2.3. Informacionet e njohura botërisht lidhur me akuzën për konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjes civile nr. 11243-03031-00-2017.

Komisioni u njoh nga mediat audiovizive dhe ato të shkruara me një lajm të shkruar dhe me një regjistrim ku ngiheshin dyshime se subjekti i rivlerësimit mund të jetë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka pirë kafe me drejtorin e "***", z. B. B., në bar-restorant "***" në hotel

⁴⁷ Shih relacionin për denoncimet dosja - ANEKSI nr. 6.

“***” në Tiranë, dhe ky takim mund të konsiderohej si ndërhyrje në gjykimin e çështjes civile nr. 11243-03031-00-2017.

Menjëherë sapo u njoh me këtë lajm, u kërkua informacion nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me qëndrimin e tij zyrtar për këtë çështje, dhe në datën 02.07.2018, me shkresën e protokolluar pranë Komisionit, me nr. 5016 prot., ai dha shpjegime të hollësishme që kundërshtonin këtë lajm të publikuar, duke vënë në dispozicion dokumentacion provues të marrë nga Gjykata e Lartë. Më tej, Gjykata e Lartë vuri në dispozicion të Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë 04.07.2018, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin për këtë çështje me qëllim sqarimin e rrethanave të çështjes që nga momenti i paraqitjes së kërkesës nga ankuesit deri sot.

Bazuar në këto informacione dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit apo ndikimit, për këtë çështje civile, për arsye se:

2.3.a. Në datën 06.06.2018, shtetasit A. S., dhe A. B., palë e paditur në çështjen civile me nr. 11243-03031-00-2017, me palë ndërgjyqëse V. H., etj., me objekt “Detyrimin e palës së paditur të njohin paditësit pronarë mbi 60 % të aksioneve të shoqërisë “***”, ka bërë ankesë dhe kërkesë pranë Gjykatës së Lartë, për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i kësaj çështjeje civile, për shkak se në datën 24.05.2018, subjekti ka pirë kafe me drejtorin e “***”, z. B. B., në bar-restorant “***” në hotel “***” në Tiranë. Në ankesë pretendohet se pasi subjekti ka pirë kafe me z. B. B., në datën 24.05.2018 ai ka marrë pjesë në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për gjykimin e 10 çështjeve civile.

2.3.b. Në datën 25.05.2018, në përmbushje të detyrimit ligjor për të plotësuar trupat gjykues si gjyqtar i parë i gatshëm plotësues i javës nga data 21.05.2018 - 25.05.2018, është vërtetuar se Kolegji Civil ka vendosur për 10 çështje civile, nga të cilat asnjëra prej tyre nuk është çështja civile me nr. 11243-03031-00-2017.

2.3.c. Në datën 08.06.2018 (dy ditë pas ankesës), subjekti ka paraqitur përpara kryetarit të Gjykatës së Lartë, parashtrësë për rrethanat dhe qëndrimin e tij lidhur me ankesën e shtetasve A. S., dhe A. B. Duke qenë se deri në këtë moment, ai nuk ka qenë pjesë e trupës gjykuese që do të shqyrtonte çështjen, ka bërë me dije se nëse në të ardhmen, për shkak të procedurave të shortimit do të gjendet përpara detyrimit për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes civile me nr. 11243-03031-00-2017, do të kërkojë të mos jetë në përbërje të trupit gjykues që do të ngarkohet me shqyrtimin e kësaj çështjeje.

2.3.d. Në datën 11.06.2018, sipas procesverbalit të datës 11.06.2018, për plotësimin e Kolegjit Civil me anëtarin e tretë të trupit gjykues (për shkak të dorëheqjes së gjyqtarit M. B.), subjekti është caktuar pjesë e trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes nr. 11243-03031-00-2017,

2.3.e. Në datën 11.06.2018, subjekti ka parashtruar përpara kryetarit të Gjykatës së Lartë, së është para detyrimit të pashmangshëm të heqjes dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, si dhe qëndrimin dhe motivet për të miratuar dorëheqjen nga gjykimi i çështjes me nr. 11243-03031-00-2017.

2.3.f. Çështja me nr. 11243-03031-00-2017 është në fazën “studim i çështjes”, pra nuk ka hyrë në proces gjykimi.

3. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në faktet dhe provat që ky trup gjykues administroi dhe mori në shqyrtim, si më sipër në këtë vendim, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit:

- a. Ka treguar aftësi të larta profesionale (neni 72 i ligjit).
- b. Ka treguar aftësi organizative të mjaftueshme (neni 74 i ligjit).
- c. Ka reflektuar etikë të lartë në punë, si dhe angazhim të mirë ndaj vlerave profesionale të tij si gjyqtar (neni 75 i ligjit).
- d. Ka treguar aftësi të larta personale dhe angazhim profesional në ushtrimin e detyrës (neni 76 i ligjit).

Gjatë procesit të vendimmarrjes është marrë në konsideratë bashkëpunimi dhe qëndrimi i subjektit gjatë procesit të rivlerësimit profesional, sipas nenit 48 të ligjit 84/2016, i cili ka dhënë shpjegime të hollësishme për parregullsitë e konstatuara, në parashtrimet e datës 16.07.2018, dhe në seancën dëgjimore, duke mbajtur qëndrim reflektues dhe duke pranuar se, pavarësisht ngarkesës së lartë në punë, gjithmonë ka vend për t’u përmirësuar profesionalisht në drejtim të organizimit të punës dhe administrimit të dosjeve gjyqësore.

Veç sa më sipër, gjatë procesit të rivlerësimit profesional, Komisioni mban në konsideratë faktin se për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, nuk ka pasur të dhëna që me veprimet ose mosveprimet e tij të ketë ndikuar në mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore, apo qëndrime të mbajtura prej tij të kenë sjellë si pasojë cenimin e të drejtave të palëve në gjykimin e çështjeve. (neni E, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës).

Sa më sipër, në përputhje me nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, pasi ka marrë në konsideratë propozimin e relatores së çështjes për vlerësimin “i aftë”, çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme në punë dhe, për këto arsye, vlerësohet i aftë profesionalisht.

V. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 23.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Dvorani, gjatë së cilës ai paraqiti parashtrimet e tij dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të

rivlerësimin kalimtar të subjektit z. Ardian Dvorani të bazohet në vlerësimin tërësor të të tria kritereve, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të procesit të rivlerësimin, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimin, dëgjoi subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore: Aneks 1- dosja e ILDKPKI-së; Aneks 2 - dosje e ILDKPKI-së; Aneks 3 - dosja e Komisionit; Aneks 4 - dosja e komunikimit me subjektin, Aneks 5 - dosje e komunikimit me subjektin, Aneks 6 – dosja e denoncimeve nga publiku, përfundoi procedurën e rivlerësimin kalimtar për subjektin e rivlerësimin, z. Ardian Dvorani, shpall këtë vendim sot, në datën 25.07.2015, sipas nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

1. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se mosdeklarimi i likuiditeteve, nuk ka sjellë asnjë nga pasojat e parashikuara në pikat, b, c, ç, dhe d të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimin, z. Ardian Dvorani, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni DH), ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimin, z. Ardian Dvorani, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

3. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), rezultoi se subjekti i rivlerësimin është i aftë profesionalisht.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimin:

- ➔ Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë (neni 59/a i ligjit);
- ➔ Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59/b i ligjit);
- ➔ Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 59/c i ligjit).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni, bazuar në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimi, z. Ardian Dvorani, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 25.07.2018.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Roland ILIA

ANËTAR/RELATOR

Firdes SHULI

ANËTARE

Etleda ÇIFTJA

Sekretare gjyqësore

Ina Serjanaj